



**Tel: +355 4 22 69097**  
**+355 4 22 69325**  
**Fax:**  
**E-Mail: info@dpa.gov.al**

## Politika për akreditimin ndër-kufitar

**Kodi DA-PO-012**

**Rishikim nr 3**  
**Data: 7.06.2019**

**Faqe 1 nga 2**

## Politika për akreditimin ndër-kufitar

### 1. Fusha e aplikimit

Ky dokument përcakton politiken e DPA mbi akreditimin ndërkufitar dhe akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA që lëshojnë raportet e testimit dhe certifikatat jashtë Shqipërisë, duke marrë në konsideratë politikat dhe legjislacionin ndërkombëtar.

### 2. Referencat:

- EA Politika ndërkufitare, EA-2/13
- ILAC Politika ndërkufitare, ILAC GD21
- ISO/IEC 17011:2017 “Vlerësimi i konformitetit– *Kërkesa për organizmat akreditues që akreditojnë organe të vlerësimit të konformitetit*”.
- Rregullorja 765/2008 “*Kërkesa për akreditimin dhe mbikëqyrjen e tregut për tregtimin e produkteve*”
- Ligji nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”.
- IAF MD2 “Transferimi I Certifikimit të sistemeve të menaxhimit të akredituar”.

### 3. Politika Ndërkufitare

Politika e DPA është që të kontribojë në zhvillimin e akreditimit në Rajon, Europë dhe në Botë. DPA ofron shërbimin e akreditimit tek organet e vlerësimit të konformitetit si një aktivitet jo fitimprurës.

Është politikë e DPA që të mos konkurojë me trupat akreditues të tjerë.

Aplikuesit për akreditim dhe organet e vlerësimit të konformitetit të akredituar nga DPA mund të krijojnë degë ose vendndodhje kritike ku kryhen aktivitete të vlerësimit të konformitetit.

Organet e vlerësimit të konformitetit të cilët janë të akredituar nga DPA mund të dëshirojnë të lëshojnë raporte apo certifikata me simbolin e DPA në vendet e tjera jashtë Shqipërisë në këto kushte:

- Shtetet në të cilat raportet ose certifikatat e akredituara janë lëshuar nga zyra qendrore e OVK-së ose nga degë të saj dhe,
- Shtetet në të cilat OVK operojnë dhe në të cilat kryhet një ose më shumë aktivitete kritike pavarësisht nga marrëdhënia ligjore e këtyre degëve me zyrën mëmë të OVK.



**Tel: +355 4 22 69097**  
**+355 4 22 69325**  
**Fax:**  
**E-Mail: info@dpa.gov.al**

## Politika për akreditimin ndër-kufitar

**Kodi DA-PO-012**

**Rishikim nr 3**  
**Data: 7.06.2019**

**Faqe 2 nga 2**

Për zbatimin e kësaj politike dhe për të kryer vlerësimin në vend të vendndodhjeve kritike dhe degëve, DPA do të ndjekë udhëzuesit ndërkombëtar (EA-2/13, IAF GD3 and ILAC-G21) dhe kryen këtë punë me nënkontraktim me organizmat akreditues lokal nëse kjo është e mundshme.

Në rastet kur OVK nuk pranon përfshirjen e trupit akreditues lokal në vlerësimin e tij atëherë DPA do të ofrojë këtë shërbim në këto kushte:

- OVK i jep DPA-së një arsye të justifikueshme dhe të dokumentuar në lidhje me mospranimin e trupit akreditues lokal.

- Një anëtar i stafit të DPA do të jetë prezent në vlerësimin fillestar dhe në cdo vlerësim tjetër nuk konsiderohet e nevojshme.

- DPA ka burime të arsyeshme dhe kompetencë për të kryer vlerësimin e aktiviteteve të OVK të kryera jashtë duke përfshirë por jo duke u limituar në kompetencën për të vlerësuar kërkesat ligjore në lidhje me aktivitetin e OVK, përkthimin dhe interpretimin, etj.;

- OVK premtan që ndërmerr në kohën e duhur të gjitha rregullimet administrative që janë të nevojshme për DPA për të vlerësuar aktivitetet që OVK ka kryer jashtë vendit;

- Akreditimi i kryer nga DPA është i lejuar nga kërkesat rregullatore dhe statutore të aplikueshme.

#### **4) Detyrimet e aplikuesve dhe organeve të vlerësimit të konformitetit të akredituar nga DPA.**

- Cdo fillim viti OVK e akredituara që kanë lëshuar raporte/certifikata të akredituara jashtë Shqipërisë, duhet të raportojnë për këtë aktivitet tek DPA.
- Aplikuesit duhet të paraqesin tek DPA të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për vlerësimin e aktivitetit të tyre jashtë Shqipërisë. Në rast se ky aplikues e ka kryer këtë aktivitet më parë atëherë ai duhet të paraqesë në DPA një raport të aktivitetit të tij jashtë Shqipërisë.
- Në rastet e zgjerimit të fushës së akreditimit me vendndodhje kritike ose degë, OVK e akredituar duhet të paraqesë në DPA të gjithë dokumentacionin që DPA kërkon të paktën dy muaj përpara vizitës mbikëqyrëse të planifikuar.
- Trupat e certifikimit të sistemeve të menaxhimit duhet të raportojnë mbi numrin e certifikatave të transferuara nga trupat e tjerë certifikues nga një vit më parë.

Data: 7.06.2019

Drejtori i Përgjithshëm  
Armond HALEBI